



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 153/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Shiqeri Halili, komisioner i subjekti politik Partia e Drejtësisë (PD) nga dega në Ferizaj në Vendvotimin (VV) 2512D/01R, për shkak se nuk i ka vulosur 3 (tri) fletëvotime gjatë procesit të votimit për Raundin e dytë të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 30.05.2012, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, ashtu që Shiqeri Halilit, komisioner i subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD) nga dega në Ferizaj i ndalohej për 3 (tre) muaj të marrë pjesë në Zgjedhje të organizuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të Republikës së Kosovës, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor nga plotfuqishmëria e këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 27.05.2012, nga subjekti politik PDK dega në Ferizaj ka pranuar një ankesë, me të cilën pretendohet se në shkollën fillore “DITURIA” në fshatin Dardani, anëtari i Vendvotimit (VV) 2512D/01, ka bërë shkeljen e Rregullës Zgjedhore me nr. 11/2009, duke mos e respektuar procesin zgjedhor siç është paraparë në Kodin Zgjedhor, respektivisht duke mos i vulosur 3 (tri) fletëvotime. Ankuesi pretendon se fletëvotimet e pavulosura do të konsiderohen të pavlefshme sipas Kodit Zgjedhor, në ankesë mëtej është theksuar se në këtë rast është dëmtuar procesi zgjedhor, sepse votuesit e këtyre tre fletëvotimeve kanë qenë të njohur për personin e lartcekur Shiqeri Halili.

PZAP-i, me datë 28 dhe 29.05.2012, përmes postes elektronike emailit zyrtare të PZAP-it i ka informuar komisioneret e VV te cekur me lartë me kopjen e skanuar të ankesës Anr.153/2012 të datës 27.05.2012 dhe ka kërkuar sqarime respektivisht deklarim me shkrim lidhur me pretendimet ankimore nga Agim Bytyqi - Kryesues i

VV 2512d/01, Shiqeri Halilin, Bardhyl Topalli, Rrahman Kurti, Premtim Bajrami, Lumturie Shala dhe Besim Xhakli, të gjithë komisioner.

PZAP-i po ashtu me 28.05. 2012, me qëllim të vërtetimit të rastit dhe të pretendimeve ankimore kërkoi nga KQZ-ja që të siguroi materialin e votimit për VV2512d/01, Librin e Votimit, Formularin e Përputhjes së Rezultateve (FPR).

PZAP-i për të vërtetuar në mënyrë të drejtë çështjen faktike, administroi provat që gjenden në shkresat e lendes si: pretendimet ankimore, përgjigjen e kryesit të supozuar, deklaratat e komisionerve të VV2512d/01, Librin e Votimit, FPR dhe Raportin e Hetimit nga Zyrtarët e QNR-së, gjeti se ankesa është e bazuar.

Nga pretendimet ankimore rezulton se nuk janë vulosur 3 (tre) fletëvotime është i vërtet gjë të cilën e ka pranuar edhe vetë i sipërshënuari mirëpo nga të gjitha deklaratat e komisionerve poashtu edhe nga komisioneri subjektit politik PDK, vërtetohet se personi në fjalë këtë gabim e ka bërë pa qëllim (pakujdesia).

Nga deklaratat e komisionerve të lartcekur vërtetohet se mos vulosja 3 (tre) fletëvotimeve nga Anëtari i Vendvotimit 2512/01 Shiqeri Halili, ishte gabim i pa qëllimshëm të cilin gabim e ka pranuar edhe vete anëtari i lartcekur me deklaratën e tij dhe pas shënimit të rastit në Librin e Votimit siç deklaruan komisionerët kanë vazhduar me procesin e votimit (për kundër shkeljes së bërë).

Pretendimet nga përgjigjja në ankesë e Shiqeri Halili - komisioner në VV2512d/01 nga subjekti politik Partia e Drejtësisë (PD) dega në Ferizaj, në të cilën theksohet se pretendimet ankimore nga përfaqësuesi i PDK-së janë të pavërteta ngase mos vulosja e fletëvotimeve është bërë pa qëllim dhe jo me qëllim siç pretendohet në ankesë nga subjekti politik PDK. Siç potencon i sipërshënuari fletëvotimet e pavulosura kanë qenë 3 (tre) fletëvotimet e para dhe posa e ka vërejtur që nuk i ka vulosur fletëvotimet pa hezitim i ka informuar të gjithë komisionerët e VV2512d/01, mëtej thekson se ka qenë një veprim i paqëllimshëm dhe se përmbyllja e procesit është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit duke përfshirë edhe anëtarin e subjektit politik PDK Besim Xhakli dhe se procesi ka shkuar mirë.

PZAP-i, nga materiali i KQZ-së - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), nga Libri e Votimit, FPR dhe në Raporti i hetimit nga zyrtarët e QNR-së, vërtetoi se në VV2512d/01 janë shpall të pavlefshme 6 (gjashtë) fletëvotime, prej të cilave 3 (tre) fletëvotime ishin të pa vulosura dhe 3 (tre) fletëvotime ishin vulosur edhe dy këndet e subjekteve politike në fletëvotime.

PZAP-i pas vlerësimit të gjitha provave të administruara dhe duke i marr parasysh të gjitha rrethanat konstatoi se Shiqeri Halili - komisioner në VV2512d/01, ka bërë shkelje të dispozitës të nenit 120.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) e cila e minon integritetin e zgjedhjeve për shkak se nuk janë vulosur 3 (tre) fletëvotime andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 120 paragrafi 3 pika (d) të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP, nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24)*

orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 153 /2012 më datën 30.05.2012.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

